

VENDIM
Nr. 84/2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 69/2021, “PËR ÇAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I, të vendimit nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputetja Milva Ekonomi caktohet anëtare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 14.9.2023.